



Republika Kosova – Republic of Kosovo



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK
REGULATORNA KOMISIJA JAVNE NABAVKE
PUBLIC PROCUREMENT REGULATORY COMMISSION

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Memorandum Mirëkuptimi

ndërmjet

Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës dhe

Organit Shqyrtues të Prokurimit të Republikës së Kosovës

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) i Republikës së Kosovës, "Palët"

Bazuar në nenin 90 dhe 102 të Ligjit për Prokurim Publik dhe Rregulloret e punës së të dyja Palëve, dhe duke marrë parasysh rëndësinë e koordinimit ndër-institucional për të ofruar shërbime publike cilësore, Palët bien dakord për:

Neni 1

Qëllimi

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi ka për qëllim të përcaktojë parimet e përgjithshme të bashkëpunimit në fushën e prokurimit publik, e në veçanti të mbështesë përpjekjet e përbashkëta për sigurimin e një procesi efikas, efektiv dhe transparent të prokurimit publik në Kosovë.
2. Bashkëpunimi në mes të KRPP-së dhe OSHP-së do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në shkëmbimin e informatave, mbajtjen e takimeve të rregullta të përbashkëta lidhur me adresimin e çështjeve specifike të prokurimit, bashkërendimin e veprimeve si dhe hartimin e politikave me qëllim të përmirësimit të praktikave të prokurimit publik.
3. KRPP dhe OSHP do t'i ofrojnë njëra tjetrës mbështetje dhe bashkëpunim të ndërsjellë në përmbushjen e qëllimit dhe obligimeve të përcaktuara me këtë Memorandum Mirëkuptimi, në pajtim me ligjin dhe aktet tjera nënligjore që rregullojnë fushë veprimtarinë e këtyre dy institucioneve.

Neni 2

Fushëveprimi

1. KRPP dhe OSHP do të punojnë bashkërisht në:
 - 1.1. Themelimin e grupit punues me përbërje nga ekspertë nga të dyja Palët;
 - 1.2. Organizimin e takimeve të rregullta dhe të strukturuar, me udhëheqje rotative mes dy Palëve, për të adresuar çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e drejtë të Ligjit të Prokurimit Publik.
 - 1.3. Ndërmarrjen e koordinuar të masave me qëllim të reduktimit të korrupsionit;
 - 1.4. Ndërmarrjen e masave me qëllim të përmirësimit të perceptimit si dhe ngritjes së transparencës, efikasitetit dhe përgjegjshmërisë në fushën e prokurimit publik;
 - 1.5. Përmirësimin dhe avancimin e platformës së e-prokurimit për qëllime të ngritjes së efikasitetit dhe transparencës në prokurimin publik;
 - 1.6. Avancimin e mëtutjeshëm të sistemeve elektronike;
 - 1.7. Shkëmbimin e rregullt të përvojave në fushën e prokurimit publik;
 - 1.8. Shkëmbimin e informatave në lidhje me aktivitetet e ndërgjegjësimit me qëllim të lehtësimit të punës së secilës Palë;
 - 1.9. Koordinimin dhe bashkërendimin e veprimeve ndërmjet dy Palëve;
 - 1.10. Përbushjen e veprimeve që kërkohen në agjendën e Integritetit Evropian;
 - 1.11. Ndërmarrjen e masave në zhvillimin e mëtutjeshëm të burimeve njerëzore;
 - 1.12. Hartimin e strategjisë së përbashkët, planit të aktivitetit si dhe zbatimin e Strategjisë së Prokurimit Publik.

Neni 3

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

1. KRPP inkurajohet t'i japë prioritet kërkesave të OSHP-së për interpretime dhe opinione;
2. KRPP do të komunikojë drejtpërdrejtë me OSHP-në lidhur me çështjet e prokurimit që ndërlidhen me opinionet e lëshuara nga KRPP;
3. KRPP obligohet që t'i përmbahet vendimeve të marra në takimet e rregullta me OSHP-në ashtu siç janë regjistruar dhe aprovuar në procesverbal;
4. KRPP obligohet që të informojë OSHP-në për çfarëdo ndryshimi në politika, rregulla apo platformën e e-prokurimit që mund të ketë ndikim në vendim-marrjen e OSHP-së.

Neni 4

Organi Shqyrtues i Prokurimit

1. OSHP do të konsultojë opinionet e KRPP-së për rastet për të cilat KRPP ka lëshuar opinion
2. OSHP do të konsultohet me KRPP-në kur ankesat ndërlidhen me çasjen në platformën e e-prokurimit.
3. OSHP obligohet që t'i përmbahet vendimeve të marra në takimet e rregullta me KRPP-në ashtu siç janë regjistruar dhe aprovuar në procesverbal.

Neni 5

Kuadri procedural i aktiviteteve të përbashkëta

1. Palët bien dakord që të mbajnë takime të rregullta me qëllim të zgjidhjes së çështjeve/problemeve të përsëritura në fushën e prokurimit publik.
 - 1.1 Takimet e përbashkëta ndërmjet KRPP-së dhe OSHP-së do të mbahen çdo muaj gjatë gjashtë muajve të parë dhe pastaj për çdo tremujor;
 - 1.2 Palët obligohen të mbajnë radhë në thirrjen/organizimin e takimeve;

- 1.3 Pala që organizon takimin duhet të jetë Pala udhëheqëse e takimit dhe duhet të sigurojë agjendën, vendin dhe mbajtjen e procesverbalit në takim;
- 1.4 Palët do të draftojnë një format standard të procesverbalit. Procesverbali i takimit duhet të aprovohet nga të dyja palët dhe veprimet e dala nga aty duhet të jenë obliguese për Palët;
- 1.5 Palët obligohen që të caktojnë stafin kompetent që do të merr pjesë në takime varësisht nga fushat të cilat trajtohen në takim;
- 1.6 Se paku një pjesëmarrës në takim nga secila Palë duhet të ketë kompetenca vendim-marrëse.
- 1.7 Çdo takim i ardhshëm duhet të fillojë me shqyrtimin e përmbushjes së veprimeve të identifikuara në takimin/takimet paraprak/e.

Neni 6

Financimi

1. Ky Memorandum nuk ka ndonjë zotim të fondeve. Megjithatë, palët pajtohen se janë të gatshme të përdorin burimet e tyre për zbatimin e detyrimeve të dala nga ky Memorandum.
2. Palët mbesin të gatshme të aplikojnë bashkërisht për grante me qëllim të zbatimit të projekteve të përbashkëta.

Neni 7

Mënyra e Bashkëpunimit

1. KRPP dhe OSHP do të emërojnë personat përgjegjës për të lehtësuar dhe koordinuar zbatimin të këtij Memorandum Mirëkuptimi dhe veprimeve që dalin si rezultat i saj.

Neni 8

Dispozitat fundit

1. Ky memorandum do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga Palët dhe do të mbetet në fuqi deri në ndryshimin e tij, ose ndërprerjen nga njëra palë, me pëlqim të dyanshëm.
2. Memorandumi i Mirëkuptimit mund të plotësohet apo ndryshohet me marrëveshje me shkrim mes dy Palëve.
3. Çdo mosmarrëveshje lidhur me zbatimin e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit do të zgjidhet në mes Palëve me negociata dhe marrëveshje shtesë.

Neni 9

Kopjet e memorandumit

1. Memorandumi nënshkruhet në dy kopje identike, një për secilën Palë.

NË DËSHMI TË KËSAJ, përfaqësuesit e autorizuar të Palëve vendosin nënshkrimet e tyre më poshtë.

Për: Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik


Osman VISHAJ – Kryetar



Për: Organin Shqyrtues të Prokurimit


Blerim DINA – Kryetar



Prishtinë, 14 tetor 2020